


UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"  
Prizren  
22.03.2022  
308 01-121



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
Nr. Prot. \_\_\_\_ Prizren, \_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

Qendra e Biznesit Suharekë  
Nr. Prot. \_\_\_\_ Suharekë, \_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të

### UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

dhe

### QENDRËS SË BIZNESIT SUHAREKË

**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren**, institucion i arsimit të lartë në Kosovë, me adresë rr. "Shkronjat" nr.1, Prizren, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj

dhe

**Qendra e Biznesit Suharekë**, me adresë rr. "Brigada 123" pa nr., Suharekë, me numër fiskal 600759560, përfaqësuar nga Mr. sc Refki Zogaj.

Te dy institucionet pajtohen të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional. Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

#### Neni 1

##### Qëllimi i Marrëveshjes:

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të sipër shënuara.

Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithanshem edukativ dhe profesional të dy institucioneve.

Rekomandimet dhe ekspertiza profesionale janë të nevojshme veçmas në: projekt-idetë, projektet rajonale dhe ndërkombëtare, projektet pilot dhe programet e caktuara që kanë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë marrëveshje.

- Marrëveshjet e mëtejshme lidhur me ndonjë organizim te veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja dhe efektet juridike**

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Afati i marrëveshjes mund të shtyhet nëse palët janë dakort për rinovimin e saj me shkrim. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon ta zgjidhe këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara. Mos rinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

#### **Neni 5**

##### **Standardet dhe Konfidencialiteti**

Të dyja palët janë të detyruara të përmbushin këtë marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë. Asnjëra nga palët nuk do t'i përdorë dhe nuk do t'ju tregojë të tretëve informacionet konfidenciale të palës tjetër apo informacionet e përbashkëta përveç informacioneve që nuk bien ndesh me konfidencialitetin.

#### **Neni 6**

##### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre të mos cenojnë interesat e njëra-tjetrës.

Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje në mënyrë të përsëritur nga njëra prej palëve, palës tjetër i lind e drejta që me një njoftim me shkrim 3 muaj përpara të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme. Në çdo rast detyrimet ndërmjet palëve që lidhen me kohën kur marrëveshja ishte në fuqi duhet të shlyhen.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe palët angazhohen të negociojnë për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme. Për çdo element ligjor që nuk është parashikuar në këtë marrëveshjeje